REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

ΔКСК

ДРЖАВНА КОМИСИЈА ЗА СПРЕЧУВАЊЕ НА КОРУПЦИЈАТА

KSHPK

KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i njohur, në vazhdimin e seancës së 50-të, të mbajtur më datë 22.007.2021 morri,

## VENDIM

Numri i aplikimit 12-4707 / 1 të datës 08.10.2019 i dorëzuar nga parashtrues i njohur **REFUZOHET.**

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka bazë për veprim kompetent sepse provat e dorëzuara nuk i referohen personave zyrtarë ose institucioneve të cilët me veprime të paligjshme i kanë shkaktuar dëm denoncuesit.

Lënda me numër 12 -4707 e vitit 2019 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Kopje nga vendimi të dorëzohet deri te parashtruesi i denoncimit.

## Arsyetim

Lënda u formua në bazë të dokumenteve të dorëzuara të regjistruar në arkivin e Komisionit Shtetëror me numrin 12- 4707/1 të datës 08.10.2019, të dorëzuara nga parashtrues i njohur --------------- nga --- -------------.

Kopjet e dokumentacionit që lidhen me ndërtimin e objektit u dorëzuan - shtëpi familjare e dyfishtë e cila gjendet në Komunë -------------- , pa shpjegim tekstual dhe nuk ka pohime për paligjshmëri në procedurë.

Denoncuesi dorëzoi kopje nga dokumentacioni i mëposhtëm:

- Aktvendim për ndarjen e tokës ndërtimore të pazhvilluar (plani) për përdorim në qytet --------, me PU nr. ------- nga --------- 1988, lëshuar nga Njësia e Ekonomisë dhe Financave;
- Aktvendim për -------- 1988 me PU nr. ------- lëshuar nga Drejtoria e të Ardhurave Shoqërore;
- Llogaritja e pagesës së fondeve për ndërtimin e strehimoreve me nr. 144 të ----- 1988, lëshuar nga Njësia e Urbanizmit, Banimit dhe Çështjeve Komunale;

- Aktvendim për lokacionin me nr. ---- nga ---- 1988, lëshuar nga Komuna e ------, Njësia e Urbanizmit, çështjet komunale dhe banimit;
- Procesverbal për linjën e ndërtimit për ndërtimin e një shtëpie të re për rrethimin e oborrit, me nr. ----- nga ----- 1988, lëshuar nga Komuna -------;
- Leje ndërtimi me PU nr. ----- nga ------- 1988, lëshuar nga Njësia e Ndërtimtarisë, Urbanizmit, Banimit dhe Çështjeve Komunale të Komunës ----------;
- Listë të posedimit - ekstrakti i transkriptit nr. 2021 i regjistruar me numrin ------- 1988;
- Aktvendim për privatizimin e tokës ndërtimore të fituar me kompensim, të lëshuar nga Ministria e Financave-Drejtoria për Çështjet Pronësore - juridike, me plotfuqishmëri me datë --------. 2011;
- Vërtetim i lëshuar nga Agjencia e Kadastrës me nr. --------- nga -------. 2010;
- Kopje nga plani kadastral me nr. ------ të datës ----- 2010, lëshuar nga Agjencia e Kadastrës të Republikës së Maqedonisë;
- Lista e pronave -----Transkript nga ------. 2019;
- Llogaritja e kompensimit për përcaktimin e statusit ligjor të ndërtesës së ndërtuar pa leje me kërkesë të investitorit, me numër PU1 nr. ------ nga ------. 2019;
- Pëlqim urban për ndërtesë pa leje me PU1 nr. ------ nga -----. 2019 lëshuar nga Komuna ------------;
- Konkluzion për pagesën e kompensimit për përcaktimin e statusit juridik të një objekti ilegal me numër PU 1 nr. ------- nga -------. 2019;
- Aktvendim për përcaktimin e statusit juridik të objekteve pa leje me nr. PU1 nr. ------- nga ------. 2019;
- Lista e pronave me numër -----të datës ------. 2019;

Në bazë të gjitha rrethanave dhe dokumentacionit të dorëzuar të përfshirë në denoncim të lëndës, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, kompetencat e saj, në denoncimin e lëndës përcaktoi se dokumentet e dorëzuara nuk tregojnë akte të paligjshme ose të papranueshme të personave zyrtar në ushtrimin e kompetencave publike dhe detyrës zyrtare për shkak të cilave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT

Kryetar,
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te:
Arkivi
Parashtruesi

Punoi: KZ, Këshilltar
Miratoi: K:N, anëtar i KSHPK - së

Adresa :Rr.Nëna më e Shenjtë e Zotit Nr. 3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë Veriore
Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë Veriore
email: contact@dksk.org.mkemail: contact@dksk.org.mk
tel: +389 2 3248 930
https://www.dksk.mk https://www.dksk.mk